
ORCA
organizata për rritjen e cilësisë në arsim

Integriteti akademik, publikimi shkencor dhe justifikimi i titujve akademikë në Universitetin e Prishtinës

PRISHTINË, KORRIK 2020



Integriteti akademik, publikimi shkencor dhe justifikimi i titujve akademikë në Universitetin e Prishtinës

PRISHTINË, KORRIK 2020

Publikues:
ORCA – Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim
www.orca-ks.org
info@orca-ks.org
Simon Shiroka, H-11, Nr. 8
Prishtina, 10000, Kosova

Hulumtues:
Adea Kondirolli
Gramos Buçinca
Skord Retkoceri
Saranda Sylejmani
Dibran Hoxha
Liridona Ademaj

Autorë:
Gramos Buçinca
Skord Retkoceri
Rron Gjinovci

Dizajn dhe Layout:
Envinion

Prishtinë, korrik 2020



“Ati ynë që je në qiell, jepna fuqinë ta mbajmë gojën mbyllur kur s’kemi gjë për të thënë. Falna durimin të thellojmë një punë përpara se të shkruajmë mbi të! Frymëzona me një ndjenë të mprehtë të drejtësisë që të flasim jo vetëm me paanësi, por edhe të sillemi ashtu! Shpëtona nga grackat e gramatikës, nga shtrembërimet e gjuhës dhe nga lajthitjet e shtypit. Ashtu qoftë!”

[Faik Konica]

PËRMBAJTJA

DEFINIME 7

PARATHËNIE NGA JEFFREY BEALL 8

HYRJE 11

PASQYRA AKADEMIKE E UP-SË 16

- Numri i publikimeve shkencore në Universitetin e Prishtinës 16
- Mesatarja e punimeve për profesor 18
- Analiza moshore dhe gjinore e profesorëve pa asnjë punim shkencor 20
- Publikimi në revista të dyshimta 23
- Justifikimi i titujve akademikë 25
- Justifikimi i titujve i zbërthyer në gjini 28
- Justifikimi i titujve i zbërthyer në grupmosha 31

PASQYRA AKADEMIKE PËR FAKULTETE 33

- Fakulteti i Bujqësisë dhe i Veterinarisë 35
- Fakulteti i Edukimit 40
- Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit 45
- Fakulteti Ekonomik 49
- Fakulteti Filologjik 54
- Fakulteti Filozofik 59
- Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike 64
- Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike 69
- Fakulteti Juridik 74
- Fakulteti i Mjekësisë 79
- Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe i Arkitekturës 84
- Fakulteti i Shkencave Matematike – Natyrore 89

METODOLOGJIA 94

DEFINIME

- **Punime me koeficient –** konsiderohen punimet e publikuara në revista siç është përcaktuar me ligjet dhe rregullativat në fuqi.

- **Pjesëmarrje në punime –** punimet ku profesorët marrin pjesë si autorë pavarësisht renditjes, pra jo vetëm si autor i parë apo korrespodent.

- **Punime në revista të dyshimta –** punimet të cilat janë në revista apo në botues të listuar në listën Beall.

- **Justifikimi i titullit –** të pasurit e numrit të nevojshëm të publikimeve shkencore për titullin përkatës sipas ligjeve dhe rregullativave në fuqi.

- **Burra dhe gra –** Gjinia e presupozuar e personave në bazë të emrit pa paragjykuar identifikimin e tyre personal.



Jeffrey Beall është një profesor i asocuar dhe bibliotekar akademik i pensionuar në Universitetin e Kolorados Denver. Më parë ai ka punuar si bibliotekar në Universitetin e Harvard. Pas identifikimit dhe emërimit të fenomenit të botuesve grabitqarë, ai ka publikuar lista të tyre nga 2011 deri 2017. Hulumtimet dhe shkrimet e tij për botimin shkencor janë publikuar në shumë revista shkencore, dhe ai është ftuar të flasë në shumë konferenca e seminare në Amerikë Veriore, Azi, dhe Evropë.

PARATHËNIE NGA JEFFREY BEALL

Integriteti akademik është duke marrë shumë vëmendje kohëve të fundit, dhe jo vetëm për shkak të problemeve që shkaktojnë botuesit grabitqarë (të dyshimtë). Ueb faqet e rrjeteve sociale tashmë ofrojnë një mënyrë për hulumtuesit të ndajnë problemet që i identifikojnë ata në artikuj shkencor me komunitetin e gjerë shkencor. Një ueb faqe e tillë – PubPeer – është një faqe e popullarizuar për hulumtues ku ata ndajnë kopjim potencial që shohin në artikuj të botuar, fotografi të edituara me PhotoShop, fotografi të ndryshuara për t'i përshtatur të dhënat e gjetura me përfundimet e artikullit.

Kur identifikohet një artikull mashtrues, hulumtuesit njoftojnë revistën ku është botuar. Por, edhe pse ka prova të mjaftueshme, shumë revista refuzojnë të ndërmarrin masa, si përmirësimi ose largimi i artikullit. Dhe këto revista "fajtore" nuk janë gjithmonë të botuara nga botues grabitqarë. Shumë botues të respektueshëm kanë refuzuar të hetojnë raportimet e problemeve etike në revistat që ata botojnë, duke lënë publikime të dyshimta të botuara në platformat e tyre.

Unë besoj që disa databaza shkencore i kanë ulur standardet, duke shtuar shumë revista grabitqare dhe të dyshimta në listën e revistave të indeksuara. Kur mësohet që një revistë "e lehtë" është shtuar në një databazë të respektueshme, disa hulumtues dorëzojnë punimet e tyre dhe i botojnë shpejtë në revistën e lehtë, duke marrë kredite hulumtimi nga universitetet e tyre nëse universiteti i tyre e përdorë atë databazë si kriter pranueshmërie ose miratimi për revistat.

Databazat indeksuese shkencore si Web of Science dhe Scopus janë produkte komerciale, dhe ato konkurrojnë me njëra tjetrën për biznes prej universiteteve dhe bibliotekave akademike. Ato shesin produktet e tyre duke u mburrur që databazat e tyre janë më gjithëpërfshirëse, një praktikë që ka dërguar deri te indeksimi i shumë revistave grabitqare.

Disa universitete kanë provuar ta parandalojnë këtë problem dhe problemin e revistave grabitqare në tërësi duke u fokusuar në citimet e hulumtuesve në vend të numrit të artikujve që ata botojnë. Nëse artikujt e një hulumtuesi citohen shpesh në revista të respektueshme, hulumtuesi merr kredite. Por edhe kjo masë është e korruptueshme, sepse hulumtuesit tash bëjnë marrëveshje për të cituar punimet e njëri tjetrit, duke rritur citimet në mënyrë joetike.

Botuesit grabitqarë vazhdojnë të jenë një problem i madh pavarësisht përpjekjeve për t'i ekspozuar ata dhe për të ua ulur ndikimin. Vazhdimisht dalin botues dhe revista grabitqare të reja – siç mund ta dinë personat me email adresë universitare – duke përfshirë shumë në shkencat biomjekësore. Bota nuk ka nevojë për revista të reja të mjekësisë, sepse ka mjaftueshëm. Çfarë ka nevojë shkenca është recensentë (ang. peer reviewers) më të mirë dhe më të shumtë, si dhe një sistem botimi shkencor më selektiv që boton vetëm hulumtime të recensuara dhe të cilësisë më të lartë.

Ky raport tregon që 39% e profesorëve të Universitetit të Prishtinës nuk kanë botime shkencore. Disa kanë botuar artikuj në revista joshkencore. Unë mendoj që është më mirë të mos kesh botime shkencore sesa të botosh në revista grabitqare. Mësimdhënësit e mirë janë të nevojshëm në një universitet të fortë, dhe disa profesorë mund të zgjedhin të përqendrohen në mësimdhënie cilësore. Për ata, mundësia për të botuar në revista të respektueshme mund të vijë më vonë.

Populli i Kosovës është me fat që ka një organizatë të dedikuar për promovimin e integritetit në hulumtim, siç është ORCA. Unë mendoj që Kosova është po ashtu me fat që organizata më e suksesshme për integritet akademik është një OJQ, sepse kjo e eliminon politikën nga hetimi dhe nga zbatimi i integritetit në hulumtim shkencor.

Disa shtete, duke përfshirë dhe timin, kanë organizata qeveritare të dedikuara për zbatimin e integritetit akademik, por ato janë joefektive. Në ShBA, Zyra për Integritet në Hulumtim është e politizuar, punon ngadalë, dhe shumë nga vendimet e saj hidhen poshtë ose nuk zbatohen. Në Indi, Komisioni Universitar për Grante nuk respektohet ndërkombëtarisht dhe është joefektiv për kontrollimin e mashtrimit masiv në hulumtim dhe botim shkencor që ndodh në atë vend.

Promovimi i integritetit në hulumtim është detyrë e nevojshme dhe e rëndësishme. Hulumtimi në disa shtete, si Rumania, India, dhe disa shtete afrikane, ka fituar reputacion të keq për shkak të sjelljeve joetike të disa hulumtuesve, sa që i gjithë hulumtimi dhe të gjithë hulumtuesit nga ato shtete tash janë të dyshimtë.

Pra, puna e ORCAs ndihmon në përmirësimin e reputacionit ndërkombëtar të vendit duke nxjerrë në pah revistat grabitqare dhe duke inkurajuar profesorët e universiteteve të shmangin publikimin në to. Kjo është mirë edhe për shtetin edhe për shkencën.

Unë e uroj ORCA-n për punën shembullore në 2019 dhe i uroj sukses në 2020 dhe tutje.

HYRJE

Në dhjetor të vitit 2016, ORCA filloi projektin e parë të saj për evidentimin e justifikimit të titujve akademik. Rezistenca e menaxhmentit të Universitetit të Prishtinës në atë kohë ishte thuajse si çdo herë tjetër, e karakterizuar me arrogancë që në fakt fshehte frikën nga protestat e mundshme të cilat tashmë ishin dëshmuar si të suksesshme në çështjet e Universitetit.

Në vitin 2013/14, Kosova si asnjë vend tjetër kishte pasur protesta domethënëse ku kërkohej shkarkimi i një rektori që ishte përfshirë në mashtrim akademik. Më vonë, ardhja e rektorit Ramadan Zejnullahu e cila u përcoll me rezistencë të jashtëzakonshme nga vet Senati i UP-së, organizatat studentore dhe organizata të tjera, tregoi se reforma ishte mjaft e vështirë. U pa qartë se as protestat e as menaxhmenti vullnetmirë, si të vetme, nuk mund ta shtynin Universitetin në reformë. Për këtë arsye ORCA zgjodhi një rrugë të ndërmjetme të kombinimit të hulumtimit dhe avokimit institucional, me protestën.

Raporti i parë i ORCA-s i shkurtit të vitit 2017, nxori një të vërtetë goditëse. Një përqindje e lartë e stafit akademik me pozita menaxheriale, 49% e tyre, nuk i justifikonin titujt e tyre akademik. Ndërkaq, 40% kishin publikuar të paktën një herë në revista mashtruese. Me gjithë reagimin arrogant të Universitetit, me ndihmën e kolegëve nga shoqëria civile e sidomos të gazetares Jeta Xharra, e cila përveç angazhimit si gazetare pati një angazhim edhe si aktiviste në çështjen e përmirësimit të gjendjes në UP, u bë e mundur që seancat e Senatit të monitorohen drejtpërdrejt nga OJQ-të dhe mediet.

Monitorimi sistematik i avancimeve me një metodë inovative të monitorimit, duke përfshirë edhe ndërhyrjen në proces me këshilla për senatorët e Senatit të UP-së, me ç'rast ORCA i dërgonte si këshillë në emailet e të gjithë senatorëve vlerësimet e saj për meritat e kandidatëve për avancim, praktikë që vazhdon edhe sot e kësaj dite, bëri që numri i avancimeve jomeritore në kuptimin e numrit të nevojshëm të punimeve shkencore për avancim të jetë zero.

Në fund të vitit 2017, ORCA nxori raportin me të dhënat e të gjithë profesorëve me tituj akademik ku doli se 72% e tyre nuk i justifikonin titujt e tyre akademik.

Për fatin e mirë, këto të dhëna nuk e lanë pa e ngacmuar Ministrin e Arsimit z. Shyqiri Bytyqi i cili pati vullnet për ta adresuar çështjen në fjalë. Në janar të vitit 2018, ai nënshkroi udhëzimin administrativ i cili do ta vendoste për herë të parë një standard për publikimet shkencore. Ky udhëzim përcaktonte platformat indeksuese ku duhej të indeksoheshin revistat shkencore që do të konsiderohen për avancim akademik në Kosovë, dhe më e rëndësishmja, u përvetësua Lista e Beall, me të cilën shërbehej ORCA në vazhdimësi, si listë e revistave dhe publikuesve që duhen shmangur me kushte të caktuara. Kjo ishte një kërkesë ekskluzive e ORCA-s, e cila përballej me kritika të paarsyeshme lidhur me atë se kush e përcakton se çka është një revistë shkencore apo kur është një revistë mashtruese, ndërkohë që bota kishte vite të tëra që e kishte rregulluar këtë çështje.

Udhëzimi Administrativ për përcaktimin e platformave indeksuese të revistave shkencore që do të merren parasysh për avancim akademik në Kosovë, ndonëse ka të metat e veta, ai doli i suksesshëm jo aq për prodhimet direkte të tij, sa për shtytjen që i dha Universitetit të Prishtinës në një ndërmarrje jashtëzakonisht të rëndësishme.

Në vitin 2019 Senati i UP-së, befasishëm, miratoi rregulloren e re të avancimeve ku ndër të tjera u vendos që nga viti 2020 lejoheshin publikime vetëm në revista me indeksim në platformat Web of Science dhe SCOPUS, ndërkaq nga 2021 avancimi mund të bëhej vetëm me punime të publikuara në revista që kanë indeksim në platformat e përmendura.

Kjo është një arritje e jashtëzakonshme. Nga viti 2017, ku gjithçka vihej në pikëpyetje nga vet Universiteti, sot Universiteti ka tejkaluar pritjet dhe kërkesat e ORCA-s "radikale" lidhur me avancimet akademike.

Sado që kemi qenë të ndarë me menaxhmentin dhe Senatin e UP-së, parë në retrospektivë, një vrojtues me të drejtë na sheh të bashkuar. Mbase, ashtu duhet ta shohim edhe ne rrugëtimin tonë që pati ulje e ngritje të entuziazmit në bashkëpunim e kundërshtime të cilat sot kanë prodhuar realitetin e ri të Universitetit që megjithëse shumëkujt i pengon, ka ngritur cilësinë. Megjithatë, jo kënaqshëm për apetitet e reformës së nevojshme e të domosdoshme, madje edhe jetike, për arsimin e lartë në vend.

Sot, 25% e të gjitha punimeve të evidentuara në CV-të e profesorëve aktualë të UP-së, i përkasin viteve 2017-2020. Në vitin 2019 janë publikuar vetëm 3 punime në revista mashtruese, ndërkaq numri i avancimeve në mënyrë jomeritore (përjashto rastin e supermenëve të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike të cilët formalisht kanë arritur që përmes mashtrimit t'i plotësojnë kushtet formale), është zero.

ORCA këtë nuk e sheh e as nuk ia atribuon si sukses vetëm vetes së vet, por po ashtu aleatëve të saj, në radhë të parë atyre aleatë në Koalicionin për Integritet dhe Transparencë në Universitet – KITU; aleatëve të saj në medie, në veçanti Jeta Xharrës e cila përveç si gazetare doli edhe në protesta së bashku me ne; aktivistëve të ndryshëm që angazhohen për përmirësimin e Universitetit; profesorëve si Ramadan Zejnullahu që inspirojnë punën tonë; si dhe zyrtarëve të universitetit dhe Ministrisë së Arsimit, të tashëm dhe që më nuk janë në funksione si Shyqiri Bytyqi, të cilët në mundësitë e tyre kanë bërë që rruga drejt realitetit të ri të Universitetit të trasohet pa pengesa të pakalueshme.

Duke mos dashur ta ulim entuziazmin e këtij suksesi të shoqërisë sonë, duhet të themi që Universiteti i Prishtinës, si më i miri në Kosovë, megjithatë qëndron ende në situatë alarmante për sa i përket kualitetit të profesorëve.

Në vitin 2019, 55% (262 nga 479) e profesorëve në UP nuk i justifikojnë titujt e tyre akademikë ku 69% të profesorëve mbi moshën 50 vjeçare nuk e justifikojnë titullin e tyre akademik.

Ndonëse ky është një përmirësim nga vitet e kaluara kur përqindja ishte 72% në vitin 2017 dhe 59% në vitin 2018, gjendja mbetet e rëndë.

39% (186 nga 479) e profesorëve nuk kanë asnjë punim shkencor të listuar në CV. Këta së bashku ia kanë borxh UP-së 724 punime shkencore.

Personi më i ri në moshë me titullin akademik “profesor i rregullt”, pra që ka kontratë permanente të punës, që nuk e justifikon këtë titull, do të pensionohet në vitin 2040. Kjo do të thotë që një fëmijë që sot është 8 vjeç dhe që vendosë të studiojë në UP, nëse supozohet se ndjek të gjitha nivelet e shkollimit me sukses të plotë, ka mundësi që të mentorohet në të gjitha gradat shkencore (Bachelor, Master, Doktoraturë) nga një profesor jomeritor.

Ne duhet dhe do ta vazhdojmë angazhimin, por qëllimet nuk do t’i realizojmë siç nuk i kemi realizuar as deri tash, pa aleatët e çmuar e pa punën e secilit prej nesh.

PASQYRA AKADEMIKE E UP-SË



PASQYRA AKADEMIKE E UP-SË

Universiteti i Prishtinës ka 479 profesorë që mund të evidentohen në faqen e Universitetit, 357 (75%) prej të cilëve janë burra dhe 122 (25%) janë gra. 173 (36%) janë profesorë asistentë, 157 (33%) janë profesorë të asocuar dhe 149 (31%) profesorë të rregullt.

NUMRI I PUBLIKIMEVE SHKENCORE NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS

Nga profesorët që kanë publikuar CV-të e tyre në faqen e Universitetit evidentohen si punime të vlefshme për avancim akademik – pra si autor i parë apo korrespodent, gjithsej 1469 punime. Një rritje domethënëse prej 216 punimesh në krahasim me vitin 2018 kur ishin evidentuar 1253 punime, dhe një diferencë prej 722 sosh në krahasim me 2017 kur ishin evidentuar 747 punime. Nga viti 2017 deri në vitin 2019 mund të thuhet se numri i punimeve që evidentohen si të vlefshme për avancime akademike është dyfishuar, pra për 727 punime. Në këtë dyfishim ka luajtur rol presioni për përditësimin e CV-ve, ku një numër i punimeve të pa evidentuara më parë janë shtuar ndërkohë. Pra ky numër nuk e paraqet numrin e punimeve të publikuara në këtë periudhë (2017-2019), por që janë evidentuar si të vlefshme për avancime akademike përgjatë viteve 2017-2019.


Ndërkaq, numri i punimeve të llogaritura ku kanë marrë pjesë edhe profesorët që nuk janë autor i parë apo korrespodent për vitin 2019, është 2042. Kjo shifër paraqet një rritje prej 307 punimesh nga 1735 sa ishin evidentuar në vitin 2018; një rritje prej 722 punimesh nga 1320 sa ishin në vitin 2017. Fakti që në të njëjtën periudhë të shqyrtimit (2017-2019), për avancime vlejnë 727 punime (pra të profesorëve si autor i parë apo korrespodent) ndërkaq si punime të veçanta (të çfarëdolloj autorësie) konsiderohen 722, pra 5 më pak, tregon se mund të ketë punime që janë përdorë për të bërë avancimin e dy personave (njërit si autor i parë tjetri si korrespodent), gjë që është e paraparë me rregullativat në fuqi.

Viti 2017 shënon vitin me më së shumti punime të llogaritura ku kanë marrë pjesë edhe profesorët që nuk janë autor i parë apo korrespodent, me 263 sosh që nga viti 1988 kur është regjistruar publikimi i parë i tillë.

Përgjatë viteve 2017, 2018 dhe 2019 janë publikuar 512 punime në revista shkencore, që paraqet 25% të numrit total të punimeve të evidentuara në UP që nga viti 1988.

39% (186 nga 479) e profesorëve nuk kanë asnjë punim shkencor të listuar në CV. Ndonëse e dhënë shumë shqetësuese, kjo paraqet një përmirësim nga vitet 2018 dhe 2017 kur kjo përqindje ishte 45% respektivisht 44%.

Afër gjysma (48%) e profesorëve mbi moshën 50 vjeçare (122 nga 255) nuk kanë asnjë punim shkencor të listuar në CV-të e tyre.



MESATARJA E PUNIMEVE PËR PROFESOR

Mesatarja e punimeve shkencore për profesor në UP është 4.26. Duke pasur parasysh që 186 profesorë nuk kanë fare punime shkencore, mesatarja e punimeve për profesor mes atyre që kanë publikuar të paktën një punim do të dilte 7 punime për profesor.

Fakulteti me mesataren më të lartë të punimeve për profesor është Fakulteti i Shkencave Matematike Natyrore me 8.89 punime për profesor. Ndërkaq, nga shkencat shoqërore mesataren më të lartë vazhdon ta ketë Fakulteti i Edukimit me 3 punime për profesor.

Ndonëse ka pasur rritje në krahasim me vitin 2018, Fakulteti Filozofik për vitin 2019 bie nën Fakultetin e Shkencave Sportive dhe është i fundit me 1.22 punime për profesor.

Fakulteti me më së shumti punime shkencore është FSHMN me gjithsej 587. Fakulteti me më së paku punime shkencore është Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit me gjithsej 22.

Profesorët e shkencave shoqërore, për nga numri i publikimeve shkencore mbesin shumë më mbrapa kolegëve të tyre nga shkencat ekzakte.

PUBLIKIMET SHKENCORE PËR PROFESOR

Nr.	Fakultetet në Universitetin e Prishtinës	Nr. i publikimeve	Nr. i profesorëve	Punime unike për profesor
1	Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore	587	66	8.89
2	Fakulteti i Mjekësisë	525	74	7.09
3	Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë	209	38	5.50
4	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	126	26	4.85
5	Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike	79	24	3.29
6	Fakulteti i Edukimit	112	37	3.03
7	Fakulteti Ekonomik	121	44	2.75
8	Fakulteti Juridik	81	41	1.98
9	Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës	59	30	1.97
10	Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit	22	13	1.69
11	Fakulteti i Filologjisë	71	45	1.58
12	Fakulteti Filozofik	50	41	1.22
	TOTAL 2019	**2042**	**479**	**4.26**
	Total 2018	**1735**	**465**	**3.73**
	Total 2017	**1320**	**481**	**2.74**

ANALIZA MOSHORE DHE GJINORE E PROFESORËVE PA ASNJË PUNIM SHKENCOR

Nga 186 profesorë pa asnjë punim shkencor, 121 janë mbi moshën 50 vjeçare, 24 janë të moshës 40 deri 50 vjeçare dhe vetëm dy të moshës nën 40 vjeçare. Tri fakultetet me më së shumti profesorë pa asnjë punim shkencor janë ai i Mjekësisë (30), i Juridikut (21) dhe i Filologjisë (20). Tri fakultetet me më së paku profesorë pa asnjë punim shkencor janë ai i Shkencave Matematike-Natyrore (7), i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (8) dhe i Inxhinierisë Mekanike (9).

Tri fakultetet me përqindjen më të madhe të profesorëve pa asnjë punim shkencor janë ai i Edukimit Fizik dhe i Sportit (85%), i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës (57%) dhe i Juridikut (51%). Tri fakultetet me përqindjen më të ulët të profesorëve pa asnjë punim shkencor janë ai i Shkencave Matematike-Natyrore (11%), i Bujqësisë dhe Veterinarisë (29%) dhe i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (33%).

NUMRI I PROFESORËVE PA ASNJË PUNIM SHKENCOR, I ZBËRTHYER SIPAS GRUPMOSHËS

Nr.	Fakultetet në Universitetin e Prishtinës	NËN 40	40 DERI 50	MBI 50	Mungon informacioni	Totali i profesorëve pa asnjë punim shkencor	Totali i profesorëve
1	Fakulteti Filozofik	1	0	10	4	15 (37%)	41
2	Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore	1	2	3	1	7 (11%)	66
3	Fakulteti i Filologjisë	0	5	13	2	20 (44%)	45
4	Fakulteti Juridik	0	2	7	12	21 (51%)	41
5	Fakulteti Ekonomik	0	3	15	1	19 (43%)	44
6	Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës	0	0	17	0	17 (57%)	30
7	Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike	0	1	7	0	8 (33%)	24
8	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	0	0	7	2	9 (35%)	26
9	Fakulteti i Mjekësisë	0	1	15	14	30 (40%)	74
10	Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë	0	4	6	1	11 (29%)	38
11	Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit	0	1	9	1	11 (85%)	13
12	Fakulteti i Edukimit	0	5	12	1	18 (49%)	37
Totali i zbërthyer në grupmoshë		**2**	**24**	**121**	**39**	**186 (39%)**	**479**

Nga 186 profesorë pa asnjë punim shkencor vetëm 36 (19%) janë gra, ndërkaq 150 (81%) janë burra. Brenda gjinisë së tyre del se 29% e grave janë pa asnjë punim shkencor, ndërkaq 42% e burrave janë pa asnjë punim shkencor.

Nga shifrat e nxjerra sipas fakulteteve është e qartë se kur vjen puna te avancimi akademik, ndaj grave ka zbatim më rigoroz të rregullave sesa ndaj burrave, çka përbën një formë të avancuar të diskriminimit gjinor.

NUMRI I PROFESORËVE PA ASNJË PUNIM SHKENCOR I NDARË SIPAS GJINISË

Nr.	Fakultetet në Universitetin e Prishtinës	Gra	Burra
1	Fakulteti Filozofik	1	14
2	Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore	2	5
3	Fakulteti i Filologjisë	5	15
4	Fakulteti Juridik	4	17
5	Fakulteti Ekonomik	5	14
6	Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës	2	15
7	Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike	1	7
8	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	0	9
9	Fakulteti i Mjekësisë	8	22
10	Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë	1	10
11	Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit	1	10
12	Fakulteti i Edukimit	6	12
Totali		**36 (19%)**	**150 (81%)**

PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA

152 profesorë kanë publikuar 532 punime në revista të dyshimta. Kjo paraqet një rritje nga viti i kaluar ku ishin 502 punime të tilla nga 153 profesorë. Ndonëse në vitin 2018 dhe 2019 ka pasur rënie drastike të punimeve në revista të dyshimta, numri total i tyre është rritur si rrjedhojë e përditësimit të CV-ve. Në vitin 2018 ka pasur 19 punime të tilla, ndërkaq në vitin 2019 vetëm tri.

Nga 152 profesorë që kanë publikuar në revista të dyshimta, 101 (66%) janë burra, dhe 51 (34%) janë gra. Është evidente se në të gjitha fakultetet gratë janë më të vëmendshme në ruajtjen e integritetit akademik sesa burrat.


Profesorët e FSHMN kanë publikuar më së shumti në revista të dyshimta, gjithsej 188 punime nga 37 profesorë.



PUBLIKIMET NË REVISTA TË DYSHIMTA

Nr.	Fakultetet në Universitetin e Prishtinës	Numri i punimeve	Numri i profesorëve	Profesorët burra që kanë publikuar në revista të dyshimta	Profesorët gra që kanë publikuar në revista të dyshimta
1	Fakulteti Filozofik	10	7	4	3
2	Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore	188	37	30	7
3	Fakulteti i Filologjisë	7	1	1	0
4	Fakulteti Juridik	26	4	3	1
5	Fakulteti Ekonomik	53	14	7	7
6	Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës	13	3	2	1
7	Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike	24	12	8	4
8	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	15	7	6	1
9	Fakulteti i Mjekësisë	104	28	15	13
10	Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë	50	21	19	2
11	Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit	7	2	2	0
12	Fakulteti i Edukimit	35	16	4	12
	TOTALI 2019	**532**	**152**	**101**	**51**
	Totali 2018	**502**	**153**	**mungon informacioni**	**mungon informacioni**
	Totali 2017	**352**	**137**	**mungon informacioni**	**mungon informacioni**

Viti 2016 ka më së shumti punime në revista të dyshimta me gjithsej 86. Ndërkaq nga viti 2017 shihet rënie drastike e publikimeve të tilla. Në shkurt të vitit 2017 ORCA pati publikuar raportin e parë të saj për integritetin akademik.



JUSTIFIKIMI I TITUJVE AKADEMIKË

Në vitin 2019, 55% (262 nga 479) e profesorëve në UP nuk i justifikojnë titujt e tyre akademikë. Ndonëse ky është një përmirësim nga vitet e kaluara kur përqindja ishte 72% në vitin 2017 dhe 59% në vitin 2018, gjendja mbetet e rëndë.

Sa më i lartë titulli akademik, aq më e madhe mundësia që profesori nuk e justifikon titullin akademik. 99 nga 149 profesorë të rregullt (66%) nuk e justifikojnë titullin e tyre akademik, 93 nga 156 profesorë të asocuar (60%) nuk e justifikojnë titullin e tyre akademik dhe 70 nga 174 profesorë asistentë (40%) nuk e justifikojnë titullin e tyre akademik.

Shprehur në përqindje del se 66% e profesorëve të rregullt nuk e justifikojnë titullin e tyre akademik, ndërkaq në 2018 përqindja ishte 76%, kurse në 2017 ishte 87%.


60% e profesorëve të asocuar nuk e justifikojnë titullin akademik, ndërkaq në 2018 ishin 65% të tillë, kurse në 2017 ishin 79%.

40% e profesorëve asistentë nuk e justifikojnë titullin akademik, në 2018 ishin po ashtu 40% të tillë, kurse në 2017 ishin 51%.

Për justifikimin e të gjithë titujve të evidentuar do të duheshin publikuar edhe 724 punime shkencore, çka paraqet edhe "borxhin akademik" që këta profesorë ia kanë Universitetit të Prishtinës.

Në këtë rezultat, sidomos te grupmosha më e re, ka ndikuar monitorimi i procesit të avancimeve akademike për të cilin mund të konstatohet se që nga viti 2017 kur ka filluar ky monitorim dhe sidomos nga viti 2018 kur është futur në fuqi udhëzimi administrativ që përcakton platformat indeksuese, nuk është shënuar asnjë rast i avancimeve pa justifikim formal të titullit akademik, çka nuk ishte praktikë para vitit 2017 kur ORCA kishte publikuar raportin e parë të saj lidhur me çështjen në fjalë.

JUSTIFIKIMI I TITUJVE NË UP



JUSTIFIKIMI I TITUJVE

Nr.	Fakultetet në Universitetin e Prishtinës	Profesorët asistentë		Profesorët e asocuar		Profesorët e rregullt	
		✓	−	✓	−	✓	−
1	Fakulteti Filozofik	16	5	2	9	1	8
2	Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore	22	5	10	6	14	9
3	Fakulteti i Filologjisë	6	6	5	18	2	8
4	Fakulteti Juridik	6	6	5	6	4	14
5	Fakulteti Ekonomik	3	5	12	8	4	12
6	Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës	6	11	2	6	2	3
7	Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike	4	2	6	3	2	7
8	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	4	3	2	0	10	7
9	Fakulteti i Mjekësisë	17	11	10	16	6	14
10	Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë	9	4	5	7	4	9
11	Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit	0	2	1	6	0	4
12	Fakulteti i Edukimit	11	10	3	8	1	4
TOTALI PËR TITULL 2019		**104 (60%)**	**70 (40%)**	**63 (40%)**	**93 (60%)**	**50 (34%)**	**99 (66%)**
Totali për titull 2018		**98 (60%)**	**64 (40%)**	**58 (35%)**	**107 (65%)**	**33 (24%)**	**105 (76%)**
Totali për titull 2017		**80 (49%)**	**84 (51%)**	**37 (21%)**	**140 (79%)**	**18 (13%)**	**122 (87%)**

Justifikimi i titujve i zbërthyer në gjini

UP ka 123 gra dhe 356 burra si profesorë me tituj akademikë. 40% (49 nga 123) e grave nuk e justifikojnë titullin e tyre, krahasuar me 60% (213 nga 356) të burrave. Në shumicën e fakulteteve numri i burrave që nuk e justifikojnë titullin është më i madh sesa i atyre që e justifikojnë titullin. Përjashtim bëjnë Fakulteti i Mjekësisë dhe i Edukimit Fizik dhe Sportiv ku numri i grave që nuk e justifikojnë titullin akademik është më i madh se i atyre që e justifikojnë.

JUSTIFIKIMI I TITUJVE SIPAS GJINISË

		PROFESORËT GRA		PROFESORËT BURRA	
Nr.	**Fakultetet në Universitetin e Prishtinës**	✓	−	✓	−
1	Fakulteti Filozofik	7	1	12	21
2	Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore	10	2	36	18
3	Fakulteti i Filologjisë	10	8	3	24
4	Fakulteti Juridik	2	4	13	22
5	Fakulteti Ekonomik	9	5	10	20
6	Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës	6	2	4	18
7	Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike	5	3	7	9
8	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	1	0	15	10
9	Fakulteti i Mjekësisë	12	15	21	26
10	Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë	2	1	16	19
11	Fakulteti i Shkencave Sportive	0	1	1	11
12	Fakulteti i Edukimit	10	7	5	15
	Totali i zbërthyer në gjini	**74 (60%)**	**49(40%)**	**143 (40%)**	**213 (60%)**

Te profesorët gra, 67% e justifikojnë titullin profesor asistent, 62% e justifikojnë titullin profesor i asocuar dhe 36% titullin profesor i rregullt.

JUSTIFIKIMI I TITUJVE TE PROFESORËT GRA

Titujt	**Profesorë Asistent**		**Profesorë të Asocuar**		**Profesorë të Rregullt**	
Fakultetet	✓	−	✓	−	✓	−
Fakulteti Filozofik	7	1	0	0	0	0
Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore	3	2	6	0	1	0
Fakulteti i Filologjisë	6	2	4	4	0	2
Fakulteti Juridik	0	1	2	2	0	1
Fakulteti Ekonomik	2	2	4	0	3	3
Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës	3	1	2	1	1	0
Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike	3	0	2	1	0	2
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	0	0	1	0	0	0
Fakulteti i Mjekësisë	7	5	3	5	2	5
Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë	2	1	0	0	0	0
Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit	0	1	0	0	0	0
Fakulteti i Edukimit	8	4	1	2	1	1
Totali (përqindjet)	**41 (67%)**	**20 (33%)**	**25 (62%)**	**15 (38%)**	**8 (36%)**	**14 (64%)**

Te profesorët burra, 55% e justifikojnë titullin profesor asistent, 32% e justifikojnë titullin profesor i asocuar dhe 33% titullin profesor i rregullt. Në krahasim me profesorët gra, justifikimi i titujve të profesorit të asocuar te profesorët burra është më i vogël.

JUSTIFIKIMI I TITUJVE TE PROFESORËT BURRA

Titujt	**Profesorë Asistent**		**Profesorë të Asocuar**		**Profesorë të Rregullt**	
Fakultetet	✓	−	✓	−	✓	−
Fakulteti Filozofik	9	4	2	9	1	8
Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore	19	3	4	6	13	9
Fakulteti i Filologjisë	0	4	1	14	2	6
Fakulteti Juridik	6	5	3	4	4	13
Fakulteti Ekonomik	1	3	8	8	1	9
Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës	3	10	0	5	1	3
Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike	1	2	4	2	2	5
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	4	3	1	0	10	7
Fakulteti i Mjekësisë	10	6	7	11	4	9
Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë	7	3	5	7	4	9
Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit	0	1	1	6	0	4
Fakulteti i Edukimit	3	6	2	6	0	3
Totali (përqindjet)	**63 (55%)**	**50 (45%)**	**38 (32%)**	**78 (68%)**	**42 (33%)**	**85 (67%)**

Justifikimi i titujve i zbërthyer në grupmosha


Profesorët që u takojnë grupmoshave më të reja del se janë më të përgjegjshëm në raport me punën akademike. Vetëm 15% e profesorëve nën moshën 40 vjeçare nuk e justifikojnë titullin e tyre akademik, krahasuar me 31% të profesorëve mes moshës 40-50 vjeçare që nuk e justifikojnë titullin e tyre akademik, apo me 69% të profesorëve mbi moshën 50 vjeçare të cilët nuk e justifikojnë titullin e tyre akademik.

JUSTIFIKIMI I TITUJVE AKADEMIKË SIPAS GRUPMOSHËS

Nr.	Fakultetet në Universitetin e Prishtinës	NËN 40		40 DERI 50		Mbi 50		Mungon informacioni	
		✓	−	✓	−	✓	−	✓	−
1	Fakulteti Filozofik	7	1	6	3	2	14	4	4
2	Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore	5	2	19	6	21	9	1	3
3	Fakulteti i Filologjisë	0	2	10	7	2	21	1	2
4	Fakulteti Juridik	4	0	4	3	3	11	4	12
5	Fakulteti Ekonomik	0	0	10	5	7	19	2	1
6	Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës	2	0	4	3	3	17	1	0
7	Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike	1	0	8	1	3	10	0	1
8	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	1	0	6	0	8	8	1	2
9	Fakulteti i Mjekësisë	1	0	12	2	20	25	0	14
10	Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë	4	0	10	6	4	13	0	1
11	Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit	0	0	0	1	1	10	0	1
12	Fakulteti i Edukimit	3	0	7	5	3	16	2	1
Totali i zbërthyer në grupmoshë		**28 (85%)**	**5 (15%)**	**96 (69%)**	**42 (31%)**	**77 (31%)**	**173 (69%)**	**16 (28%)**	**42 (72%)**


Personi më i ri në moshë me titullin akademik “profesor i rregullt”, pra që ka kontratë permanente të punës, që nuk e justifikon këtë titull, do të pensionohet në vitin 2040. Kjo do të thotë që një fëmijë që sot është 8 vjeç dhe që vendosë të studiojë në UP, nëse supozohet se ndjek të gjitha nivelet e shkollimit me sukses të plotë, ka mundësi që të mentorohet në të gjitha gradat shkencore (Bachelor, Master, Doktoraturë) nga një profesor jomeritor.

PASQYRA AKADEMIKE PËR FAKULTETE



Logot e përdorura në këtë seksion, janë logot zyrtare të fakulteteve të UP-së dhe mund të gjinden në www.uni-pr.edu.

FAKULTETI I BUJQËSISË DHE I VETERINARISË



Nga 38 profesorë në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë, 53% (20) prej tyre nuk e justifikojnë titullin akademik. Nga ata që nuk e justifikojnë titullin e tyre akademik, 4 nga 13 janë profesorë asistentë krahasuar me vitin 2018 që ishin 1 nga 10. Ndërkaq, në 2017 ishin 2 nga 10 të tillë. 7 profesorë të asocuar nga 12 sa janë gjithsej nuk e justifikojnë titullin akademik, në vitin 2018 të tillë ishin 7 nga 10, e në 2017 ishin 8 nga 10. Ndërsa, 9 nga 13 profesorët e rregullt nuk e justifikojnë titullin e tyre akademik, krahasuar me 8 nga 13 sa ishin në 2018 dhe 2017.

JUSTIFIKIMI I TITUJVE NË FAKULTETIN E BUJQËSISË DHE VETERINARISË

Vitet	Profesorët asistentë		Profesorët e asocuar		Profesorët e rregullt		Total	
	✓	−	✓	−	✓	−	✓	−
2019	**9 (69%)**	**4 (31%)**	**5 (42%)**	**7 (58%)**	**4 (31%)**	**9 (69%)**	**18 (47%)**	**20 (53%)**
2018	9 (90%)	1 (10%)	3 (30%)	7 (70%)	5 (38%)	8 (62%)	17 (51%)	16 (49%)
2017	8 (80%)	2 (20%)	2 (20%)	8 (80%)	5 (38%)	8 (62%)	15 (45%)	18 (55%)

Vetëm 45% e profesorëve burra e justifikojnë titullin, krahasuar me 67% e profesorëve gra të cilat e justifikojnë titullin e tyre akademik.

Përqindja më e madhe e justifikimit të titujve është te profesorët nën moshën 40 vjeçare, me 100% të tyre.

Profesorët në këtë fakultet kanë publikuar në total 209 punime në revista shkencore, prej tyre 108 janë të vlefshme për avancim. Në 2018 ishin evidentuar 184 punime të tilla, ndërkaq në 2017 ishin evidentuar 175 punime të tilla.

21 profesorë në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë kanë publikuar 50 punime në revista të dyshimta.


JUSTIFIKIMI I TITUJVE I ZBËRTHYER NË GRUPMOSHA DHE GJINI NË FAKULTETIN E BUJQËSISË DHE VETERINARISË

	NËN 40		40 DERI 50		Mbi 50		Mungon informacioni		Totali gjini	
Gjinitë	✓	−	✓	−	✓	−	✓	−	✓	−
Burra	2	0	10	5	4	13	0	1	16 (45%)	19 (55%)
Gra	2	0	0	1	0	0	0	0	2 (67%)	1 (33%)
Totali grupmosha	**4 (100%)**	**0 (0%)**	**10 (62%)**	**6 (38%)**	**4 (27%)**	**13 (71%)**	**0 (0%)**	**1 (100%)**	**18 (47%)**	**20 (20%)**


JUSTIFIKIMI PËR SECILIN TITULL I ZBËRTHYER NË GJINI NË FAKULTETIN E BUJQËSISË DHE VETERINARISË

	GRA		BURRA	
	✓	−	✓	−
Profesor i Rregullt	0	0	4	9
Profesor i Asocuar	0	0	5	7
Profesor Asistent	2	1	7	3

PUBLIKIMI SHKENCOR NDËR VITE NË FAKULTETIN E BUJQËSISË DHE VETERINARISË



PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA NË FAKULTETIN E BUJQËSISË DHE VETERINARISË




PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA SIPAS GRUPMOSHËS DHE GJINISË NË FAKULTETIN E BUJQËSISË DHE VETERINARISË

	Nën 40	40 - 50	Mbi 50	Mungon infor-macioni	Totali sipas gjinisë
Burra	1	8	9	1	19
Gra	1	0	0	1	2
Totali sipas moshës	**2**	**8**	**9**	**2**	**21**

PROFESORËT PA ASNJË PUNIM SIPAS MOSHËS DHE GJINISË NË FAKULTETIN E BUJQËSISË DHE VETERINARISË

nën 40	40-50	mbi 50	Mungon in-formacioni	Burra	Gra
0	4	6	1	10	1

FAKULTETI I EDUKIMIT



Nga 37 profesorë në Fakultetin e Edukimit, 59% (22) prej tyre nuk e justifikojnë titullin akademik. Nga ata që nuk e justifikojnë titullin e tyre akademik, 10 nga 21 janë profesorë asistentë krahasuar me vitin 2018 që ishin 11 nga 21. Ndërkaq, në 2017 ishin 11 nga 22 të tillë. 8 profesorë të asocuar nga 11 sa janë gjithsej nuk e justifikojnë titullin akademik, në vitin 2018 të tillë ishin 7 nga 10, e në 2017 ishin 9 nga 10. Ndërsa, 4 nga 5 profesorët e rregullt nuk e justifikojnë titullin e tyre akademik, njëjtë sa ishin në 2018 dhe 4 nga 4 sa ishin në 2017.

JUSTIFIKIMI I TITUJVE NË FAKULTETIN E EDUKIMIT

Vitet	Profesorët asistentë		Profesorët e asocuar		Profesorët e rregullt		Total	
	✓	−	✓	−	✓	−	✓	−
2019	**11 (52%)**	**10 (48%)**	**3 (27%)**	**8 (73%)**	**1 (20%)**	**4 (80%)**	**15 (41%)**	**22 (59%)**
2018	10 (48%)	11 (52%)	3 (30%)	7 (70%)	1 (20%)	4 (80%)	14 (39%)	22 (61%)
2017	11 (50%)	11 (50%)	1 (10%)	9 (90%)	0 (0%)	4 (100%)	12 (33%)	24 (67%)

Vetëm 25% e profesorëve burra e justifikojnë titullin, krahasuar me 59% e profesorëve gra të cilat e justifikojnë titullin e tyre akademik.

Përqindja më e madhe e justifikimit të titujve është te profesorët nën moshën 40 vjeçare, me 100% të tyre.

Profesorët në këtë fakultet kanë publikuar në total 112 punime në revista shkencore, 95 të vlefshme për avancim. Në 2018 ishin evidentuar 94 punime të tilla, ndërkaq në 2017 ishin evidentuar 84 punime të tilla.

16 profesorë në Fakultetin e Edukimit kanë publikuar 35 punime në revista të dyshimta.


JUSTIFIKIMI I TITUJVE I ZBËRTHYER NË GRUPMOSHA DHE GJINI NË FAKULTETIN E EDUKIMIT

Gjinitë	NËN 40		40 DERI 50		Mbi 50		Mungon informacioni		Total gjini	
	✓	−	✓	−	✓	−	✓	−	✓	−
Burra	0	0	3	3	1	11	1	1	5 (25%)	15 (75%)
Gra	3	0	4	2	2	5	1	0	10 (59%)	7 (41%)
Totali grupmosha	**3 (100%)**	**0 (0%)**	**7 (58%)**	**5 (42%)**	**3 (16%)**	**16 (84%)**	**2 (67%)**	**1 (33%)**	**15 (41%)**	**22 (59%)**


JUSTIFIKIMI PËR SECILIN TITULL I ZBËRTHYER NË GJINI NË FAKULTETIN E EDUKIMIT

	GRA		BURRA	
	✓	−	✓	−
Profesor i Rregullt	1	1	0	3
Profesor i Asocuar	1	2	2	6
Profesor Asistent	8	4	3	6

PUBLIKIMI SHKENCOR NDËR VITE NË FAKULTETIN E EDUKIMIT



PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA NË FAKULTETIN E EDUKIMIT


